



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:229557

Datë: 29.12.2023

Numri i dokumentit: 05141244

KE.nr.101/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit TEB SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Debt Loan Recovery SH.P.K., kundër të paditurit Tony Guy N.SH., me NRB:70656779, me seli në Vushtrri, rruga “Dëshmorët e Kombit”, përfaqësuar nga B.K. dhe F.T., me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 354.10 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 18.12.2023, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, me datë 29.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit TEB SH.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Tony Guy N.SH., që paditësit t’ia paguaj borxhin në shumën e përgjithshme prej 354.10 €, (treqind e pesëdhjetë e katër euro e dhjetë cent), dhe shpenzimet gjyqësore, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- II. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi TEB SH.A., përmes të autorizuarit të tij, me datë 17.08.2017 ka paraqitur padi kundër të paditurit Tony Guy N.SH., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri të përmbush obligimin në shumën prej 354.10 €, deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet për taksa gjyqësore, për padi, për aktgjykim dhe shpenzime tjera që pësojnë, të gjitha në afat prej shtatë ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit. Nëse i padituri nuk e përmbush borxhin në afatin e parashikuar, të urdhërohen bankat komerciale – institucionet financiare në Kosovë, që nga xhirrollogaria e të paditurit të transferojn shumën e

borxhit prej 354.10 € deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet gjyqësore. Nëse borxhi nuk mund të realizohet në këto mënyra, atëherë realizimi i kërkesës së paditësit të kryhet ashtu që së pari të bëhet regjistrimi i tërë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të të paditurit, pastaj të bëhet sekuestrimi i kësaj pasurie dhe shitja nëpërmjet ankandit publik.

Përfaqësuesi i paditësit gjatë shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë. Ka shtuar se në bazë të provave që janë bashkëngjitur në padi është vërtetuar se i padituri Tony Guy N.SH., përfaqësuar nga B.K. dhe F.T. ka nënshkruar marrëveshjen për kredi me numër 9790, në bazë të së cilës ai ka marrë këtë kredi pranë bankës TEB dhe ka nënshkruar marrëveshjen mbi mbitërheqjen e mundësuar me po të njëjtin numër pra 9790. Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, ta aprovoj kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Ka deklaruar se borxhi i përgjithshëm ka qenë në shumën prej 650 €, prej të cilit 9 kështë janë paguar, ndërsa kanë mbetur pa paguar 3 kështë në vlerë prej 180 €. Për vlerën e mbetur të borxhit në kompaninë Tony Guy kanë qenë Përmbaruesi Privat, së bashku me zyrtarët e kreditorit dhe kanë marrë arkën fiskale në shumën prej 700 € dhe me të njëjtën kanë deklaruar se borxhi është përmbushur dhe kjo lëndë është përfunduar. Ka deklaruar se kjo dëshmohet me Procesverbalin për regjistrim nga Administrata e Përkohshme e Kosovës – Gjykata Themelore në Mitrovicë, të datës 14.01.2014.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik të datës 18.12.2023, bëri administrimin e të gjitha provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe atë: Marrëveshjen mbi kredinë me numër 9790 të datës 28.10.2010; Marrëveshjen mbi mbitërheqje me numër 9790 të datës 28.10.2010; Marrëveshjen mbi pengun të datës 28.10.2010; Listën e pengut të luajtshëm me numër 9790 të datës 27.10.2010; Propozimin për sekuestrim kolaterali të datës 19.04.2011 dhe Procesverbalin nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, të datës 14.01.2014.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesepadia e paditësit është e pabazuar për shkaqet si në vijim:

Nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se të njëjtit ishin në marrëdhënie detyrimore kontraktuese, nga marrëveshja mbi kredinë dhe mbitërheqje.

Në rastin konkret, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte nëse i padituri i ka mbetur borxh paditësit për shumën prej 354.10 €.

Nga Marrëveshja mbi kredinë me numër 9790 e datës 28.10.2010, rezulton se palët kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuale, sipas së cilës paditësi në cilësinë e kredidhënësit është pajtuar që kredimarrësit t'ia lëshoj kredinë në shumën prej 650 €, ndërsa i padituri në cilësinë e kredimarrësit ka marr përsipër kthimin e shumës së kredisë brenda afatit prej 12 muaj.

Nga Marrëveshja mbi mbitërheqje me numër 9790 e datës 28.10.2010, rezulton se paditësi është pajtuar që të vë në dispozicion të të paditurit mbitërheqjen deri në shumën prej 100€ gjerë më datë 28.10.2011, ndërsa i padituri ka marr përsipër pagesën e shumës totale të mbitërheqjes së mundësuar.

Nga Marrëveshja mbi pengun e datës 28.10.2010, rezulton se paditësi në cilësinë e pengmarrësit dhe i padituri në cilësinë e pengdhënësit, kanë lidhur marrëveshje mbi pengun për sigurimin e përmbushjes së obligimeve nga i padituri, të cilat dalin nga marrëveshja mbi kredinë me numër 9790 të datës 28.10.2010, ku i padituri ka lënë peng arkën fiskale.

Nga Lista e pengut të luajtshëm me numër 9790 e datës 27.10.2010, rezulton se pajisja e lënë peng ka qenë arka fiskale në vlerë totale prej 637.53 €.

Nga Propozimi për sekuestrim të kolateralit i datës 19.04.2011, rezulton se paditësi me datë 19.04.2012 ka paraqitur në Gjykatën Komunale në Vushtrri, propozim për sekuestrimin e kolateralit të lënë peng si garancion për kthimin e kredisë, në shumën prej 354.10 €, prej të cilave 284.78 € për kredi dhe 69.32 € për mbitërheqje.

Nga Procesverbali për regjistrim i datës 14.01.2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, rezulton se zyrtarët e gjykatës, përmbaruesit privat dhe zyrtarët e kreditorit,

kanë vizituar debitorin, në këtë rast të paditurin dhe kreditori (paditësi) ka pranuar të marr në posedim kolateralin e lënë peng, arkën fiskale, adapterin, pajisjen e quajtur DATECS, baterinë, letrën e arkës. Të njëjtat i janë dorëzuar me vetëdëshirë kreditorit nga debitori, dhe lënda është përfunduar me datë 14.01.2014 dhe e njëjta është arkivuar sepse kreditori nuk ka kërkuar aktvendim me shkrim.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e të autorizuarit të paditësit dhe kundërshtimet e të paditurit, lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar andaj të njëjtën e ka refuzuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 262 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (të vitit 1978, i aplikueshëm në rastin konkret) është paraparë se *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*.

Në rastin konkret nga provat e administruara, nuk është kontestuese se paditësi në përputhje me nenin 13 par.1 d), të Marrëveshjes mbi Kredinë numër 9790, datë 28.10.2010, për shkak të mospagesës së kredisë nga kredimarrësi, si kredidhënës ka marrë posedimin e kolateralit të lënë peng respektivisht ka ekzekutuar kolateralin - Arkën Fiskale pronë e të paditurit, të specifikuar në listën e pengut me numër 9790 të datës 27.10.2010. Ky fakt vërtetohet edhe nga konstatimet në Procesverbalin për regjistrim të datës 14.01.2014, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, nga i cili rezulton se paditësi ka pranuar të marr në posedim kolateralin e lënë peng-arkën fiskale dhe debitori e ka dorëzuar të njëjtën me vetëdëshirë dhe me dorëzimin e saj në posedim të kreditorit, lënda është përfunduar dhe arkivuar.

Me dispozitën e nenit 295 të LMD-së (1978) përcaktohet se: *“Detyrimi pushon kur të plotësohet, si dhe në raste të tjera të caktuara nga ligji”*, ndërsa me dispozitën e nenit 308 të LMD-së, përcaktohet se: *“Detyrimi pushon në qoftë se kreditori në marrëveshje me debitorin pranon diçka tjetër në vend të asaj që i debitohet.”*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe marr për bazë faktin se në rastin konkret palët ndërgjyqëse janë pajtuar që detyrimi monetar të cilin ka pasur i padituri ndaj paditësit të përmbushet në mënyrë alternative me dorëzimin në posedim të kolateralit të lënë peng dhe paditësi ka pranuar marrjen e tij, gjykata vlerëson se detyrimi i të paditurit është përmbushur në

mënyrë alternative në marrëveshje me kreditorin dhe si rrjedhojë është shuar raporti detyrimor mbi bazën e të cilit tani paditësi kërkon pagesën e borxhit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 450 të LPK-së, vendosi që secila palë të i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Nga arsyet e cekura më lart, e në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.101/22, datë 29.12.2023

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.